

V E N D I M
Nr.288, datë 14.6.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.132, DATË 6.3.1993 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT"

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashme, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.132, datë 6.3.1993 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, në shkronjën "A":

- Mbas emërimit "Presidentit të Republikës" shtohen emërtimet "Kryetarit dhe zëvendëskryetarëve të Kryesisë së Kuvendit Popullor".

- Në paragrafin e katërt, pas emërimit "Kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit" shtohet emërtimi "si dhe kryetarit të Komitetit Kombëtar të ish-të Përndjekurve Politikë".

- Në paragrafin e pestë, pas emërimit "kryetarit të Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit" shtohet emërtimi "nënkryetarëve të Komitetit Kombëtar të ish-të Përndjekurve Politikë".

- Paragrafi 20 ndryshohet si vijon:

"Grave, djemve të mitur deri në 18 vjeç dhe vajzave të pamartuara që bashkëjetojnë me to, të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, anëtarëve të Qeverisë, kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe anëtarëve të personelit diplomatik ose konsullor të Republikës së Shqipërisë".

- Paragrafi 21 ndryshohet si vijon:

"Guvernatorit dhe Zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë".

2. Në pikën A bëhen këto ndryshime:

- Pas emërimit "Drejtorit të Drejtorisë së Statistikës" shtohen emërtimet "Drejtorit të Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe drejtorit të Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë".

- Pas emërimit "Drejtorët e drejtorive në ministri" shtohen emërtimet "Drejtorët e drejtorive të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, të Komitetit të Shkencës e të Teknologjisë e të Komitetit Kombëtar të ish-të Përndjekurve Politikë, si dhe drejtorët e bashkësive ekonomike (korporatave)".

- Pas emërimit "Zëvendësprokurorëve të Përgjithshëm" shtohet emërtimi "Zëvendësdrejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit".

- Pas emërimit "Shefave të kabinetit dhe këshilltarëve të Presidentit, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe të Kryeministrit" shtohet emërtimi "si dhe përgjegjësve të Sektorit të Përgjithshëm në Presidencë, në Kuvendin Popullor dhe Këshillin e Ministrave".

- Pas fjalëve "Gazetarëve të ATSH, RTV dhe të atyre që punojnë në gazeta e që janë anëtarë të shoqatës së gazetarëve", shtohet emërtimi "Zëdhënësve të shtypit dhe informacionit në ministri dhe institucione të tjera qendrore".

- Pas fjalëve "Shoferëve të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetarit të Këshillit të Ministrave e të anëtarëve të Qeverisë, si dhe të kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit" shtohen emërtimet " të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi